



TIRANA

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE



KONTRATA SOCIALE

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



+355 4 22 555 14



+355 68 20 59 301



gadc@gadc.org.al



www.popalbania.info



+355 4 22 555 14

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale të 30 Qershorit 2019.

POP 2019 synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2017. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, me fonde të Ambasadës Suedeze në Tiranë.

POP 2019 do të organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamez, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP 2019 synon:

Të nxisë dialogun mes zgjedhësve dhe kandidatëve, por edhe ndërmjet kandidatëve vetë, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët do të mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre dhe do të ftohen të nënshkruajnë Kontratën Sociale mes tyre dhe qytetarëve në çdo bashki.

Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP 2019 do të përpiqet të arrijë rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjesht një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e ardhshëm të bashkive.

Të informojnë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, do t'u ofrojë qytetarëve shqiptarë një paraqitje shumë të nevojshme të ofertave të partive politike. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit.

Aktivitetet që do të organizohen në kuadër të POP 2019, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njëri-tjetrin dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike.

Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP 2019 do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre, pasi zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike në periudhën parazgjedhore është e rëndësishme. POP 2019 është një mundësi për partitë politike që të paraqesin programet e tyre të tregojnë se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të monitorohen pas Zgjedhjeve Lokale 2019 nga Rrjeti i organizatave të POP 2019 dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.


ORGANIZATAT

- | | |
|--|--|
| • Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", Tiranë | • Intelktualët e Rinj "Shpresë", Shkodër |
| • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës | • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë |
| • Qendra Rinore Vlorë | • Qendra Rinore për Progres, Kukës |
| • ACPD/Qendra "Aulona", Vlorë | • Integrimi, Aktivizimi dhe Ndërgjegjësimi i të Rinjve, Pogradec |
| • Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz | • Lëvizja "Mjaft" |
| • Epoka e Re, Fier | |

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Banorët e Bashkisë Tiranë u përfshinë në 10 Forume, të zhvilluara gjatë muajit prill 2019 me qëllim identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej 10 Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me nivele të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Pjesëmarrja sipas gjinive




Në çdonjërin prej forumeve të zhvilluara qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 26 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:



Për secilën prej 26 çështjeve objekt diskutimi qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi çështjet që përbëjnë prioritet për ta e për rrjedhojë duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në tre grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;
3. **Vijueshmëri**, përfshin çështje të cilat kanë arritur zhvillimin e pritshëm nga komuniteti dhe për to nevojitet vetëm ruajtje e të njëjtit standart nga të zgjedhurit vendorë.



25 janë prioritetet e komunitetit të prezantuara gjerësisht në vijim, sipas shkallës së rëndësisë që i ka dhënë vetë komuniteti, për të cilat do të lobohet për të qenë pjesë e axhendës së të zgjedhurve të rinj vendor, sikurse përmbushja e të cilave do të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti.

PRIORITETET E KOMUNITETIT

● Grupi i parë / NDËRHJRJE PRIORITARE ●

Janë **12 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

- Shërbimi veterinar
- Incentivat për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës
- Nxitja e bizneseve të të rinjve dhe grave
- Nxitja e punësimit
- Programe për mbështetjen e fermerëve
- Niveli i taksave/tarifave në raport me shërbimin

SHËRBIMET PUBLIKE

- Furnizimi me ujë dhe kanalizimet
- Transporti publik
- Infrastruktura, rrugë dhe trotuare
- Kopshte dhe çerdhe

DIMENSIONI SOCIAL

- Komuniteti Rom dhe Egjiptian
- Shërbime të kujdesit shoqëror për individët në nevojë

● Grupi i dytë / NDËRHJRJE DISI PRIORITARE ●

Janë **8 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

- Njoftimi i qytetarëve mbi detyrimin për taksat/tarifat

SHËRBIMET PUBLIKE

- Shkollat
- Pastrimi
- Ndriçimi
- Gjelbërimi
- Kanalet kulluese/vaditëse

DIMENSIONI SOCIAL

- Pjesëmarrja e grave në vendimarrje
- Programe dhe shërbime mbi adresimin e dhunës në familje.

● Grupi i tretë/ NDËRHJRJE VIJUESE ●

Janë **6 çështje** që kanë marrë vlerësimin më të lartë nga pjesëmarrësit në Forume.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

- Takime publike për buxhetin
- Pagesat e taksave nga qytetarët

SHËRBIMET PUBLIKE

- Pyjet dhe kullotat

DEMOKRACIA VENDORE

- Informimi dhe komunikimi
- Transparenca në vendimarrje
- Pjesëmarrja në vendimarrje

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

SHËRBIMI VETERINAR

Njësitë Baldushk, Dajt dhe Farkë vlerësojnë si prioritar shërbimin veterinar, pasi aktualisht ky shërbim ofrohet vetëm nga një veterinar në secilën prej njësive Dajt dhe Farkë, ndërsa në Baldushk nuk ka asnjë veterinar.

Prioritet 1. Zgjerim i shërbimit veterinar në njësitë Baldushk, Dajt dhe Farkë.

INCENTIVAT PËR NXITJEN E BIZNESIT DHE KRIMIN E VENDEVE TË REJA PUNËS

Ka pak informacion mbi incentivat që përdor Bashkia për të nxitur biznesin dhe krijuar vende të reja pune. Nxitja e biznesit konsiderohet prioritar nga komuniteti me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës.

Prioritet 2. Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

NXITJA E BIZNESEVE TË TË RINJVE DHE GRAVE

Vetëm 50% e përfaqësuesve të komunitetit kishin dijeni mbi programet e Bashkisë për nxitjen e biznesit të të rinjve dhe grave. Mungesa e informacionit për egzistencën e këtyre programeve i kufizon gratë dhe të rinjtë nga mundësia për tu përfshirë në to përmes aplikimit dhe më pas përzgjedhjes. Pjesa e informuar u shpreh se "Disa herë janë bërë fushata sensibilizuese për të hapur biznese dhe punësim për të rinjtë dhe gratë në nevojë, por për një kryeqytet kërkohet më shumë1."

Prioritet 3. Informimi i gjerë i grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për tu përfshirë në këto programe.

Prioritet 4. Zgjerimi i programeve egzistuese me fokus të rinjtë dhe gratë.

NXITJA E PUNËSIMIT

"Shtresa më e varfër dhe më e pashkolluar vuajnë më së shumti nga papunësia. Ka shumë të papunë dhe i vetmi informacion që kanë është egzistenca e Zyrës së Punës. Bashkia duhet të bëjë më shumë për nxitjen e punësimit.2" Sidomos të rinjtë e sapo diplomuar; Grup mosha 50 – 65 vjeç; Të pa arsimuarit më shkollë të lartë dhe ata pa një profesion; Gratë kryefamiljare; Gratë viktimë të dhunës në familje; Romët.

Prioritet 5. Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të priorizojnë grupet më pak të avantazhuara në tregun e punës.

PROGRAME PËR MBËSHTETJEN E FERMERËVE

Banorët e njësive administrative Farkë dhe Dajt nuk kishin informacion mbi egzistencën e programeve që mbështesin fermerët. "Secili ka tokën e vet dhe perpiqet ta rregullojë me sa të mundet3". Në Baldushk vijon të zbatohet një projekt i UNDP që ka mbështetur me ndërtim serash dhe me blerjen e lopëve.

Prioritet 6. Zhvillimi i programeve që mbështesin fermerët.

NIVELI I TAKSAVE/TARIFAVE NË RAPORT ME SHËRBIMIN

Përfaqësuesit e komunitetit në të gjitha Forumet u shprehën të pakënaqur me nivelin e taksave/tarifave. Ata u shprehën se ato janë të larta dhe nuk justifikojnë shërbimin apo cilësinë e tij. Në mënyrë të veçantë tarifën e ujit të pijshëm nuk i përgjigjen cilësisë dhe shërbimit. "I paguajmë detyrimet, por faturat nuk na vijnë nëpër shtëpi. Nuk jemi të kënaqur me shërbimin, sidomos me ujin, taksa e të cilit është dhe shumë e lartë4". Edhe njësia administrative Farkë nënvizoi se faturat nuk u shkojnë në shtëpi, sikurse ujë kanë një herë në 24 orë dhe tarifa që paguajnë është më e lartë se cilësia e shërbimit. Familjet që përfitojnë ndihmën ekonomike ndjejnë vështirësi në pagesën e tyre. "Taksat janë të larta. Me një asistencë sociale pagesa e tyre bëhet shumë e vështirë. Kjo kategori kërkon falje të taksave5."

Prioritet 7. Rivlerësim i nivelit të taksave dhe tarifave vendore.

Prioritet 8. Krijimi i lehtësive në nivelin e taksave/tarifave për kategoritë në nevojë.

1 Forum njësia administrative 7
2 Forum njësia administrative 3
3 Forum Njësia administrative Farkë
4 Forum njësia administrative Dajt
5 Forum njësia administrative 3

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET

Përfaqësuesit e komunitetit në të gjitha njësitë theksuan se edhe pse Bashkia ka punuar për të zgjidhur problemet e trashëguara me ujin e pijshëm dhe kanalizimet, ajo duhet të bëjë akoma shumë punë për të arritur në nivelet e duhura në këtë çështje.

Prioritet 9. Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për secilën prej njësive vijuese.

Njësia 1: Zgjidhja e furnizimit me ujë me prioritet për zonat ku uji shkon vetëm 1 herë në ditë. Masa për të shmangur bllokimin e kanalizimeve.

Njësia 2: Prioritet rruga "Budi" ku uji vjen në orën 7 të darkës dhe vetëm për dy orë. Gjithashtu uji është i pakonsumueshëm. Zgjidhje për kanalizimet në këtë njësi. Erë e padurueshme që vjen si pasojë e kanalizimeve të pa rregulluara.

Njësia 3: Furnizim me ujë të pijshëm në të gjithë njësine njësor si në Kodrën e Priftit që furnizohet me ujë pa ndërprerje. Ndërhjere për kanalizimet veçanërisht në rrugët më problematike "Ali Bahushi", "Kongresi i Manastrit" dhe "Kujtim Laro".

Njësia 4: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit.⁶

Njësia 5: Ndërhjere tek Pallatet "Agimi", në kufi me rrugën "Brigada e 8-të" ku tubacionet e ujit janë të vjetra.

Njësia 7: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit.⁷ Zgjidhja e rrjedhjes së ujërave të zeza para konvikteve të inxhinierisë së ndërtimit, ujëra që zbresin deri tek fusha e aviacionit.

Njësia 8 : Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. Ndërhjere në kanalizimet e rrugës "Ferit Xhajko".

Njësia Baldushk: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit.⁹

Njësia Dajt: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit.¹⁰

Njësia Farkë: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit me prioritet lagjia "Dina" dhe "Farkë e Vogël". Zgjidhje e problemit të derdhjes së ujërave të zeza në tokat e banorëve.

TRANSPORTI PUBLIK

Probleme me transportin u raportuan nga të tre njësitë administrative Baldushk, Dajt dhe Farkë. Oraret e mbërritjes në stacion të autobuzëve nuk dihen. Fëmijët vonohen për në shkollë dhe në shumicën e rasteve autobuzët janë të tejmbushur.

Prioritet 10. Shtimi i autobuzëve në linjat e njësive administrative Baldushk, Dajt dhe Farkë. Publikimi në stacion i orareve të mbërritjes dhe nisjes së autobuzëve.

INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

Në të gjitha Forumet u nënvizua situata shumë e mirë me rrugët kryesore dhe fakti që po vazhdon puna për të ndryshuar edhe të gjitha rrugët dytësore dhe brendësitë e lagjeve. Prioritetet e listuara i përkasin përmirësimeve në vijim në rrugët dytësore, si dhe përmirësime të ndryshme infrastrukturore.

Prioritet 11. Vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për secilën njësi.

Njësia 1: Përmirësim i trotuareve (aktualisht shumë të larta) në Rr. "Konti Leopold", si dhe rrugicave në brendësi të lagjes. Përmirësim i sinjalistikës rrugore në rrugët "Gavril Dara", "Naim Rushiti" dhe "Ali Shefqeti". Përmirësim i trotuareve në rrugën "Ali Shefqeti". Krijimi i Bibliotekës, si dhe përmirësim i godinës/ambienteve të njësive administrative.

Njësia 2: Vendosi e sinjalistikës, ndriçim dhe rregullim i trotuareve në rrugët "Hatixhe Kasemi" dhe "Budi".

Njësia 3: Rikonstruksion në rrugët "Kongresi i Manastirit", "Gjon Simoni" dhe "Ali Bahushi". Ndërhjere në bodrumet e pallateve (pallatet "Xhafize Keko" dhe tek rruga "Odhise Paskali"). Krijimi i Bibliotekës, si dhe përmirësim i godinës/ambienteve të njësive administrative.

Njësia 4: Përmirësim i trotuareve, të cilët janë të ngushta.

Njësia 4: Rikonstruksion i rrugicave, kryesisht tek rrugët "Vaso Pasha" dhe "Nikolla Tupe".

Njësia 7: Rikonstruksion në brendësi të lagjeve kryesisht tek Rr. "Dritan Hoxha" dhe "Viktor Hygo". Çlirim i hapësirave urbane. Ngritje e një këndi lojrash për fëmijë. Vendosi e administratorëve edhe në pallatet e vjetra.

Njësia 8: Rikonstruksione të rrugëve "Gjon Buzuku", "Ymer Beqiri" dhe "Riza Cerova". Vendosi e sinjalistikës rrugore. Krijimi i ambienteve për fëmijë.

Baldushk: Rikonstruksione të rrugëve dhe ndriçim.

Dajt: Rikonstruksion i rrugëve të brendshme dhe ndiçim. Zgjidhje e problemit të ndotjes akustike me lavazhet e vendosura shumë pranë godinave të banimit. Zgjidhje e problematikës së parkimit të makinave.¹¹

Farkë: Rikonstruksion i rrugëve dytësore dhe ndriçim në lagjet "Xix" dhe "Dallash". Ngritja e një këndi lojrash për fëmijë¹². Shfrytëzimi i ambientit të jashtëm të shkollës nga fëmijët për t'u aktivizuar në aktivitete të ndryshme sportive.

KOPSHTË DHE ÇERDHE

Ambientet e kopshteve dhe çerdheve egzistuese u vlerësuan shumë të mira nga të gjitha Forumet e zhvilluara. Sikurse të gjitha grupet theksuan nevojën për të shtuar në numër kopshtet dhe çerdhet. "Duhet kopshte dhe çerdhe. Nën at e reja kanë nevojë të punojnë dhe për këtë duhet që fëmijët t'i lenë diku.¹³ " Në Farkë dhe Dajt nuk ka asnjë çerdhe.

Prioritet 12. Ngritja e kopshteve dhe çerdheve të reja, në veçanti i çerdheve në Farkë dhe Dajt ku aktualisht mungojnë plotësisht

⁶ Aktualisht furnizimi tre herë në ditë, më orare dhe nuk është i përdorshëm për tu pirë. Ka erë dhe ngjyrë.

⁷ Uji e pijshëm banorët e blejnë.

⁸ Pallati 59/8 vuan shumë nga era e padurueshme që vjen si pasojë e kanalizimeve të pa rregulluara. Problem ekzistues prej 30 vjetësh tashmë.

⁹ Disa prej banorëve përdorin pusët e tyre. Uji që vjen nuk është i pijshëm.

¹⁰ Nuk ka ujë të vazhdueshëm, vjen me orare, përdoren depozita edhe pse është zona e ujit të burimit.

¹¹ Parkim i pakontrollueshëm.

¹² Farkë ¹³ Baldushk

DIMENSIONI SOCIAL

ROMËT DHE EGJIPTIANËT

Njësitë ku banon komuniteti rom ishin më të informuara për programet që zbaton Bashkia për integrimin dhe fuqizimin e këtij komuniteti. "Megjithëse ka programe, kjo kategori shpesh anashkalohet¹⁴". Pjesëmarrësit vlerësuan se strehimi i këtij komuniteti është çështja kryesore në të cilën duhet të fokusohet më shumë Bashkia edhe pse nuk është e lehtë. "Ka të pastrehë, por jo për fajin e bashkisë por sepse ata vetë kanë zgjedhur të mos jetojnë në banesa sociale¹⁵".

Prioritet 13. Trajtim më prioritet i programeve që nxisin strehimin dhe integrimin në punë të komunitetit rom.

SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR PËR INDIVIDËT NË NEVOJË

Në tërësi të gjitha grupet ishin të informuara mbi punën e Bashkisë për të mbështetur individët në nevojë për shërbime. Në njësitë administrative ku nuk ka aktualisht shërbime të kujdesit shoqëror të ngritura u vlerësua nevoja për ngritjen e tyre.

Prioritet 14. Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë, në njësi.

Njësia 2. Ngritja e një qendre komunitare për kategoritë në nevojë.

Njësia 3. Shmangia e vonësve në shpërndarjen e ndihmës ekonomike, si dhe mbështetja me më shumë shërbime e familjeve në ndihmë ekonomike, në mënyrë të veçantë përmes strehimit social. Ngritja e një qendre ditore për të moshuarit.

Njësia 5. Ngritje e një qendre komunitare për kategoritë në nevojë. Ngritje e shërbimit rezidencial për të moshuarit në nivel Bashkie. Trajtim me prioritet me strehim social të familjeve që jetojnë në bodrume dhe të grave të dhunuara.

Njësia 7. Ngritje e shërbimit rezidencial për të moshuarit në nivel Bashkie. Zgjidhje afatgjatë e strehimit për banorët që preken nga projekti i Lanës dhe Unazës së Madhe.

Baldushk. Krijimi i aksesit tek shërbimet sociale të ngritura nga Bashkia¹⁶.

Dajt. Shërbime për moshën e tretë.

Farkë. Ngritje e një qendre komunitare.

¹⁴ Njësia 3

¹⁵ Njësia 8

¹⁶ Shërbime ka në Tiranë, por janë shumë larg nga Baldushku.



● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR ●

NJOFTIMI I QYTETARËVE MBI DETYRIMIN PËR TAKSAT/TARIFAT

30% e komunitetit të përfshirë në Forume u shpreh se merrnin njoftim në banesë për detyrimin për taksat/tarifat. Pjesa tjetër u shprehën se duhet të interesoheshin vetë pranë pikave ku duhet të kryhen pagesat.

Prioritet 15. Ngritja e një sistemi të unifikuar që mundëson marrjen e njoftimit në banesë mbi detyrimin për taksat/tarifat

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

SHKOLLAT

Në të gjitha Forumet u vlerësua shumë pozitivisht gjendja e shkollave egzistuese, për shkak të reabilitimeve të kryera nga Bashkia. Nevoja për të shtuar numrin e shkollave u theksua nga pjesa dërmuese e Forumeve.

Prioritet 16. Ndërhyrje infrastrukturore në shkolla egzistuese

Prioritet 17. Ngritja e shkollave të reja në njësitë 1, 2¹⁷, 3¹⁸, 5, 8¹⁹, Baldushk²⁰, Dajt²¹

Njësia 7: Shkolla "Pjetër Budi" ka nevojë për palestër, shtesë klasash dhe laboratorët e informatikës.

Baldushk: Shkollat egzistuese kanë nevojë për përmirësime.

PASTRIMI

E përbashkëta e të gjitha grupeve është vlerësimi se cilësia e pastrimit në zonat e tyre është rritur, por duhet të vijojnë përpjekjet në vijim.

Prioritet 18. Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas njësive.

Njësia 1. Punëtorët e pastrimit duhet të kryejnë pastrimin gjatë natës dhe jo në pikun e lëvizjes së qytetarëve. Ndërhyrje e menjëherëshme për pastrim në pjesën e Shkozës së Sipërme.

Njësia 2. Duhet të shtohen koshat e plehrave.

Njësia 3. Të zgjidhet problemi i pastrimit ditët e festave, pasi punëtorët nuk pastrojnë dhe rritet ndotja.

Njësia 4. Rritje e cilësisë së pastrimit në zonën ku banon komuniteti romë dhe shtim i koshave për mbledhjen e mbeturinave.

Njësia 5. Përmirësim i cilësisë së mbledhjes së plehrave.

Njësia 7. Të bëhet dizinfektimi i vendeve të mbledhjes së plehrave dhe koshave, të cilët shpesh janë edhe të amortizuar. Gjithashtu orari i kryerjes së pastrimit në këtë njësi duhet të jetë natën ose shpejt në mëngjes, duke qenë se edhe lëvizjet e njerëzve janë më të ralla. Të vendosen edhe kontenierë për mbledhjen e kartonave.

Njësia 8. Ndërhyrje e menjëherëshme tek zonat informale, Bregu i Lumit. Më shumë kosha.

Baldushk. Përmirësim i cilësisë së pastrimit.

NDRIÇIMI

Nuk ka probleme me ndriçimin në rrugët kryesore, si dhe ka përmirësime të ndjeshme në rrugët dytësore. Ndërhyrjet në vijim lidhen kryesisht me përmirësime vijuese në rrugët dytësore.

Prioritet 19. Përmirësim i ndriçimit sipas njësive.

Njësia 1. Ndriçim në Rr "Theodhori Bej", mbi kompleksin Halili, si dhe në rrugë të tjera të brendshme.

Njësia 3. Ndërrim i vazhdueshëm i poçave që digjen. Vendosi e ndriçimit mes pallateve, si për shembull Rr. "Vangjush Miho" tek oxhaku.

Njësia 7. Ndërrim i vazhdueshëm i poçave që digjen. Vendosi e ndriçimit në rrugën "Viktor Hygo"

Njësia 8. Vendosi e ndriçimit në hapësirat mes lagjeve, në mënyrë të veçantë tek zona e ish ujësjellësit.

¹⁷ Në zonën e Depos së Ujit (rruga "Budi")

¹⁸ Në zonën e Kodrës së Priftit

¹⁹ Shkolla Skënder Çaçi vijon mësimin me dy turne dhe nga 33 veta në klasë

²⁰ Ka fshatra që janë larg dhe fëmijet e kanë vështitë të vijnë deri në qendër.

²¹ Mungon gjimnazi. Gjimnazi më i afërt 1 orë larg.

SHËRBIMET PUBLIKE

GJELBËRIMI

30% e Forumeve vlerësuan se situata e gjelbërimit është e mirë. Theksohet nevoja për shtimin e gjelbërimit në brendësi të lagjeve.

Prioritet 20. Përmirësim i gjelbërimit sipas njësive.

Njësia 1. Duhet punuar për shtimin e gjelbërimit në brendësi të lagjeve. Rr."Pasho Hysa" edhe si rrugë është shumë e prishur por edhe gjelbërim nuk ka.

Njësia 4. Duhet parqe dhe stola akoma me shumë, si për fëmijë edhe për të moshuar.

Njësia 5. Pas pallatit 21, Rr." Vaso Pasha", është bërë parkim. Të kthehet në lulishte për banorët e atyre pallateve.

Njësia 7. Në zonën "Astrit Balluku" ndodhet një shesh ndërtimi që nga viti 2000. Aty rriten barishte dhe shpesh mblidhen edhe plehra. Të sistemohet e të krijohet hapësirë për lulishte ose kënd lojrash.

KANALET KULLUESE/VADITËSE

Në njësitë administrative Baldushk, Dajt dhe Farkë u theksua se ka përmirësim të gjendjes së kanaleve kulluese dhe vaditëse, porse duhet të vijojnë ndërhyrjet në disa zona.

Prioritet 21. Ndërhyrje në kanalet kulluese/vaditëse sipas njësive.

Baldushk. Ka nevojë për disa ndërhyrje në fshatrat pak më të largët, si Shën Kolla dhe Mustafakoçi.

Farkë. Duhet përmirësuar gjendja e kanaleve kulluese në tërësi dhe në mënyrë të veçantë në Rr. "Fushjetë". Nevojë për ndërhyrje për përmirësimin e kanaleve vaditëse.

DIMENSIONI SOCIAL

PJESËMARRJA E GRAVE NË VENDIMARRJE

Ka një rritje të ndjeshme të numrit të grave në këshillin bashkiak, megjithatë përfaqësimi i grave nga zonat e ish-komunave mbetet ende i ulët.

Prioritet 22. Programe ndërgjegjësuere që nxisin rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimarrje veçanërisht në zonat e Baldushkut, Farkës dhe Dajtit.

PROGRAME DHE SHËRBIME TË BASHKISË MBI ADRESIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

70% e pjesëmarrësve në Forume ishin të informuar mbi egzistencën e programeve të Bashkisë për adresimin e dhunës në familje. Megjithatë theksuan nevojën që çështjet e dhunës në familje të vijojnë të trajtohen me prioritet nga Bashkia, në mënyrë të veçantë për parandalimin dhe identifikimin e viktimave të dhunës në familje.

Prioritet 23. Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasojat e saj.

Prioritet 24. Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet të strukturave të shërbimeve sociale.

Prioritet 25. Zgjerim i shërbimeve egzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruere për viktimat e dhunës në familje.



KONTRATA SOCIALE

Grupi i tretë/ **NDËRHJRJE VIJUESE**

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

TAKIME PUBLIKE PËR BUXHETIN

Në të gjitha Forumet u theksua se takimet për buxhetin ishin të përvitshme dhe kjo praktikë duhet të vijojë të ndiqet nga Bashkia.

PAGESAT E TAKSAVE NGA QYTETARËT

Të gjithë pjesëmarrësit në Forume u shprehën se i paguanin taksat. Në njërin prej Forumeve pjesëmarrësit u shprehën se ndiejnë që taksat nuk mbliiden kudo njësoj. Në këndvështrimin e tyre "periferia abuzon ndërsa zona qendrore, qytetarët paguajnë çdo gjë, ndërkohë që investimet më të shumta i marrin ato zona ku paguhen më pak taksa".

SHËRBIMET PUBLIKE

PYJET DHE KULLOTAT

Në njësitë e Baldushkut, Dajtit dhe Farkës diskutimin në lidhje me këtë çështje pjesëmarrësit e fokusuan më së shumti tek përdorimi i drurit për ngrohje. Në Baldushk shqetësimi i vetëm ishte çmimi i drurit të zjarrit që vlerësohej i lartë.

DEMOKRACIA VENDORE

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Në të gjitha Forumet u theksua se janë shumë të kënaqur me nivelin e informimit dhe komunikimit. Në mënyrë të veçantë theksuan lehtësinë në marrjen e dokumentave brenda ditës. Informacioni përcillej në kohë reale dhe për të gjithë është mjaft i qartë dhe i kuptueshëm.

TRANSPARENCA NË VENDIMARRJE

Bashkia përdor një numër rrugësh për të bërë publik aktivitetin e saj, sipas pjesëmarrësve në Forume. Vlerësimi i tyre për nivelin e transparencës së Bashkisë ishte shumë i lartë.

PJESËMARRJA NË VENDIMARRJE

Takimet publike të shpeshta që ndërmerr Bashkia janë forma më e përhapur që sipas pjesëmarrësve në Forume i bënte ata të përfshirë në vendimarrje. Megjithatë, "Mendimin ne e shprehim, por sa e marrin parasysh këtë nuk e dimë." – sipas pjesëmarrësve në një prej Forumeve. Shumë pak pjesëmarrës ishin të informuar mbi faktin që mbledhjet e këshillit bashkiak janë të hapura dhe të drejtën që komuniteti ka për të ndjekur këto mbledhje.






**POP
2019**

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**

KONTRATA SOCIALE



Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

